

VENDIM
Nr. 104, datë 4.2.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE E TË KRITEREVE TË SIGURISË, PJESA E DYTË, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-SË, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e dytë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pjesën e dytë të rregullave teknike për industrinë e gazit të përfshihen rregulla për sistemin e transmetimit, referuar kodeve të praktikave dhe udhëzimeve teknike në vazhdim, si më poshtë vijon:

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 260, “Cilësia e gazit”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 280-1, “Aromatizimi i gazeve”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, udhëzimi teknik G 280-3, “Gazet testuese për kalibrimin e aparateve matës të lëndës aromatizuese”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, udhëzimi teknik G 494, “Masat për mbrojtjen akustike në pajisjet dhe në stacionet e rregullimit të presionit e të matjes së gazit”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 495, “Impiantet e gazit - Mirëmbajtja”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 1000, “Kërkesat teknike për kualifikimin dhe organizimin e shoqërive për operimin e impianteve të furnizimit të publikut me gaz, nëpërmjet rrjetit të tubacioneve (Impiantet e furnizimit me gaz)”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G 1010, “Kërkesat teknike për kualifikimin dhe organizimin e operatorëve të stacioneve të gazit natyror në zonën industriale”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave GW 12, “Projektimi dhe ndërtimi i mbrojtjes katodike nga korrozioni (MKK) për enët depozituese nëntokësore dhe linjat e tubacioneve prej çeliku”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave GW 16, “Mbrojtja katodike nga korrozioni (MKK) e enëve depozituese nëntokësore dhe linjave të tubacioneve prej çeliku - Kontrolli në distancë”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave GW 350, “Lidhjet me saldim në linjat e tubacioneve prej çeliku në furnizimin me gaz dhe me ujë - prodhimi, testimi dhe vlerësimi”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave GW 1200, “Parime të përgjithshme dhe organizimi i shërbimit të gatishmërisë për shoqëritë e furnizimit të gazit dhe ato të furnizimit të ujit”;
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, udhëzimi teknik GW 14, “Riparimi i pikave me defekte, në mbështjelljet mbrojtëse, nga korrozioni i tubacioneve dhe pjesëve të linjave të tyre prej çeliku”;

Rregullat teknike për industrinë e gazit, rregullorja mbi linjat e gazit me presion të lartë.

3. Çdo dispozitë e akteve nënligjore, që bie ndesh me rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, të miratuara në këtë vendim dhe në vendimin nr.1030, datë 27.11.2013, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, të ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

